

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **QENDRA E STUDENTEVE**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **208/90500-26-1258-2-1-1**

Sa i përket tenderit për **Mirëmbajtja higjienike e objekteve të Qendrës së Studentëve**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	CAPITAL X FET SH.P.K.
NUI	811367920
Adresa	Martirët Dushi 11
Vendi	Klinë
Kodi postar	32000
Numri Telefonit	+38349616992
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	EGZON BYTYQI
Adresa elektronike	capitalxfet@gmail.com
Data e parashtrimit të ankesës	29.05.2026

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*



2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit
Adresa e plotë
Numri i Telefonit
Numri i faks-it
Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës” “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit”, apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

Mirëmbajtja higjienike e objekteve të Qendrës së Studentëve

Njoftimi për Kontrate dt 18.03.2026

Afati për ofertim 14.04.2026

Hapja e tenderëve 14.04.2026

Vendimi AK 07.05.2026

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

Jo

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

Jo

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po

Jo

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontestit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.

Kërkesa për rishqyrtim 12.05.2026

Pergjigja AK 18.05.2026*

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e

Njoftimit për Dhënie e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi Neni 10 Mjetet për promovimin e
Transparencës

Neni 11 Informatat Sekrete Afariste

Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve Neni 60 Kriteret për Dhënie
e Kontratës

Neni 61 Tenderët Jo-Normalisht të Ulët Neni 68 Gjendja Ekonomike dhe Financiare

Neni 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale Neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni
shtesë

Neni 108/A Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthejë tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjohë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Me datë 07.05.2026, Autoriteti Kontraktues – Qendra e Studentëve ka publikuar Formularin B58 “Njoftim mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues”, përmes të cilit ka propozuar për shpërbllim me kontratë operatorët ekonomikë GOE AROMA PLUS SH.P.K. dhe ALLTON SH.P.K.

Me datë 07.05.2026, është parashtruar kërkesë për qasje në dokumentacion pranë Autoritetit Kontraktues. Fillimisht, qasja është mohuar, ndërsa vetëm pas insistimit është mundësuar një qasje e pjesshme, e cila nuk është në përputhje me Ligjin për Prokurimin Publik dhe dispozitat ligjore në fuqi. Një qasje e tillë cenon dhe zbeh mundësinë efektive për parashtrimin e kërkesës për rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues, respektivisht ushtrimin e ankesës pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP).

Ndërsa me datë 12.05.2026 është paraqitur kërkesë për rishqyrtim pranë AK, ndërsa përgjigjen (vendimin) për refuzim e kemi pranuar me datë 18.05.2026 ku prape Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 108/A të LPP-së dhe parimet themelore të shqyrtimit administrativ, duke mos trajtuar në mënyrë të plotë, objektive dhe të arsyetuar pretendimet e paraqitura në kërkesën për rishqyrtim. Në vendimin mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, Autoriteti Kontraktues nuk ka dhënë arsyetim konkret lidhur me secilin pretendim ankimor të ngritur nga operatori ekonomik ankues, por është kufizuar në konstatime të përgjithshme dhe formale, pa analizuar faktet, provat dhe shkeljet konkrete të pretenduara. Mosadresimi i pretendimeve thelbësore lidhur me klasifikimin e padrejtë të dokumenteve si sekrete afariste, mosvlerësimin e ofertave jo-normalisht të ulëta, mosplotësimin e kërkesave administrative dhe teknike nga operatorët ekonomikë të tjerë, si dhe eliminimin e pabazuar të ofertës sonë, përbën shkelje serioze procedurale dhe cenim të së drejtës për mjet juridik efektiv. Autoriteti Kontraktues ka pasur obligim ligjor

që secilin pretendim ta trajtojë veçmas, me arsyetim të qartë dhe të bazuar në prova dhe dispozita ligjore, gjë që në këtë rast nuk ka ndodhur.

Meqenëse me datë 28.05.2026 nuk ka funksionuar uebfaqja e-prokurimi është shtyrë afati për ankesë për një ditë shtesë, me anë të njoftimit të vetë KRPP. Andaj brenda afatit ligjor paraqesim këtë ankesë pranë OSHP.

Fillimisht, Autoriteti Kontraktues nuk është përgjigjur lidhur me caktimin e terminit për qasje në dokumentacion, përkundër kërkesave të dërguara përmes emailit me datë 07.05.2026 dhe 08.05.2026. Më pas, kërkesa është përcjellë edhe përmes platformës e-Prokurimi. Gjithashtu, janë bërë tentativa për kontaktim telefonik, mirëpo Autoriteti Kontraktues nuk është përgjigjur.

Tentativa e fundit është realizuar përmes zyrtarit të autorizuar, z. Erion Mavraj, i cili është paraqitur fizikisht në zyrat e Autoritetit Kontraktues, mirëpo edhe atij nuk i është ofruar qasje në dokumentacionin e kërkuar.

Më pas, përmes platformës e-Prokurimi, Autoriteti Kontraktues ka ngarkuar një dokument në të cilin, ndër të tjera, ka deklaruar si vijon:

“Në lidhje me kërkesën tuaj për qasje në dokumentet në aktivitetin e prokurimit ‘Mirëmbajtja higjienike e objekteve të Qendrës së Studentëve’, me numër të prokurimit 208/90500-26-1258-2-1-1, ju njoftojmë se Autoriteti Kontraktues, në përputhje me nenin 7.4 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, është i obliguar të ofrojë qasje të arsyeshme në dokumentet përkatëse, duke respektuar parimet e transparencës dhe mbrojtjes së informatave konfidenciale.”

Arsyetimi i Autoritetit Kontraktues ka qenë se nuk ofrohet qasje fizike në dokumentacion dhe se pala duhet të specifikojë saktësisht dokumentet që kërkon, ndërsa dokumentet përkatëse do të ngarkohen përmes portalit e-Prokurimi. Megjithatë, përgjegjësia për mosofrimin e qasjes në dokumentacion mbetet përgjegjësi ligjore e Autoritetit Kontraktues, ndaj së cilës operatori ekonomik rezervon të drejtën për ndërmarrjen e veprimeve dhe masave ligjore përkatëse.

Fshehja apo mosdhënia e informatave lidhur me dokumentet publike në një procedurë të hapur të prokurimit publik konsiderohet shkelje e dispozitave ligjore në fuqi dhe, varësisht nga rrethanat, mund të përbëjë edhe bazë për përgjegjësi penale.

Duke u bazuar në nenin 7.4 të Ligjit për Prokurimin Publik, të cilit Autoriteti Kontraktues i është referuar në dokumentin e ngarkuar në platformën e-Prokurimi, vërehet qartë se dispozita në fjalë nuk ndërlidhet me kërkesën tonë për qasje në dokumentacion.

Pas insistimit të vazhdueshëm nga ana jonë, Autoriteti Kontraktues ka ofruar përmes platformës e-Prokurimi një qasje të kushtëzuar dhe të pjesshme, ku për Grupin e Operatorëve Ekonomikë të propozuar për shpërblim nuk janë bashkangjitur deklaratat për specifikimet teknike, ndonëse të njëjtat nuk përmbajnë asnjë element që mund të klasifikohet si sekret afarist apo informacion konfidencial.

Këto dokumente në bazë të lidhjes së ofertës nuk na janë dhënë:

4. 4. Qarkullimi financiar nga ATK - Aroma Plus.pdf

5. 5. ISO Certifikatat AROMA PLUS SH.P.K.pdf

6. 6. Deklarata e kerkuar nga AK.pdf

10. 10. Marrveshje Bashkpunimi per Kran.pdf

Pra, vërehet qartë se asnjë prej dokumenteve të cekura nuk përmban elemente që mund të klasifikohen si sekret afarist, ndërsa Autoriteti Kontraktues i ka keqklasifikuar ato si të tilla, me qëllim të mbrojtjes së operatorëve ekonomikë të caktuar për mangësi në dokumentacion.

Është e paqartë se si qarkullimi financiar i lëshuar nga ATK mund të klasifikohet si sekret afarist, kur raportimi i pasqyrave financiare në KKRF është obligim ligjor për ndërmarrjet e mëdha, ndërsa të njëjtat më pas publikohen dhe bëhen të qasshme për publikun në uebfaqen përkatëse.

Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 11 të LPP-së “Informatat Sekrete Afariste”, si dhe me nenin 10 “Mjetet për Promovimin e Transparencës”, duke klasifikuar padrejtësisht dokumente si sekrete afariste, ndonëse ato nuk kanë të bëjnë fare me sekret afarist, e aq më pak deklaratat që janë kërkuar nga vetë Autoriteti Kontraktues si pjesë e Dosjes së Tenderit (DT). Po ashtu, edhe marrëveshjet e bashkëpunimit, kryesisht dokumentet lidhur me pajisjet, janë klasifikuar në mënyrë të padrejtë, gjë që krijon dyshimin se disa operatorë ekonomikë nuk posedojnë pajisjet e kërkuara dhe Autoriteti Kontraktues synon ta fshehë këtë fakt, duke pamundësuar ushtrimin efektiv të së drejtës së ankimit, në kundërshtim me nenin 7 të LPP-së “Barazia në Trajtim / Jo-Diskriminimi”. Lidhur me klasifikimin e dokumenteve si “sekret afarist”, theksojmë se Autoriteti Kontraktues nuk ka paraqitur asnjë provë apo vendim formal administrativ që dëshmon se është zhvilluar procedurë e rregullt për vlerësimin dhe klasifikimin e dokumenteve si informata konfidenciale apo sekrete afariste.

Në përputhje me parimet e transparencës, proporcionalitetit dhe mbrojtjes së konkurrencës së drejtë në procedurat e prokurimit publik, klasifikimi i dokumenteve si sekret afarist nuk mund të bëhet në mënyrë automatike, arbitrare apo vetëm mbi bazën e deklarimit të operatorit ekonomik. Për një vlerësim të tillë, Autoriteti Kontraktues ka obligim që të zhvillojë procedurë të mirëfilltë administrative dhe të bëjë shqyrtim konkret të përmbajtjes së secilit dokument që pretendohet të jetë konfidencial.

Për më tepër, një veprim i tillë kërkon trajtim institucional dhe profesional nga Autoriteti Kontraktues, përkatësisht formimin e një komisioni apo grupi përgjegjës për shqyrtimin dhe vlerësimin e pretendimeve për sekret afarist, i cili do të duhej të analizonte në mënyrë konkrete nëse dokumentet përmbajnë informata që realisht përbëjnë sekret tregtar, teknik apo afarist dhe nëse publikimi i tyre do të mund të shkaktonte dëm real ekonomik për operatorin ekonomik përkatës.

Në rastin konkret, Autoriteti Kontraktues nuk ka ofruar asnjë dëshmi se është formuar ndonjë komision i tillë, nuk ka nxjerrë ndonjë akt apo vendim të arsyetuar mbi klasifikimin e dokumenteve si sekrete afariste dhe nuk ka dhënë asnjë arsyetim konkret se përse dokumentet në fjalë do të duhej të trajtoheshin si konfidenciale.

Përkundrazi, dokumentet e fshehura janë dokumente administrative dhe profesionale, të cilat ndërlidhen drejtpërdrejt me përmbushjen e kriterëve të tenderit dhe si të tilla nuk përmbajnë elemente që mund të klasifikohen ligjërisht si sekrete afariste. Andaj, kufizimi i qasjes në këto dokumente është bërë në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik dhe me qëllim të pengimit të verifikimit efektiv të ofertës së operatorëve ekonomikë të propozuar për shpërblim.

Në bazë të qasjes së pjesshme dhe të kushtëzuar të ofruar nga Autoriteti Kontraktues, vërehet se anëtari i konsorciumit ALLTON SH.P.K. nuk ka plotësuar Aneksin 3 – Kërkesa për Sekret Afarist, megjithatë Autoriteti Kontraktues ka klasifikuar deklaratat dhe dokumentet e këtij operatori ekonomik si sekrete afariste, ndonëse vetë operatori ekonomik nuk ka kërkuar një trajtim të tillë.

Po ashtu, në qasjen e ofruar nuk janë përfshirë dokumentet e përshtatshmërisë së GOE-së, përfshirë vërtetimin tatimor valid dhe certifikatat nga gjykata komerciale.

Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 59 të LPP-së “Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve” dhe nenin 61 “Tenderët Jo-Normalisht të Ulët”, duke mos e cilësuar ofertën e GOE-së së propozuar për shpërblim si ofertë jo-normalisht të ulët.

Nga analiza e çmimit të ofruar rezulton qartë se me çmimin e ofertuar nuk mund të mbulohen kostot reale të projektit. GOE-ja e propozuar për shpërblim ka llogaritur vetëm pagat e punëtorëve si në vijim:

- 30 punëtorë;
- 525.00 EUR paga bruto me 5% kontribut të punëdhënësit;
- 15,750.00 EUR në muaj;
- 2,835.00 EUR TVSH 18%;
- 18,585.00 EUR gjithsej në muaj;
- 36 muaj kontratë;
- 669,060.00 EUR gjithsej.

Nga ky kalkulim vërehet se GOE-ja e propozuar nuk ka përfshirë fare shpenzimet për materialin harxhues të nevojshëm për realizimin e mirëmbajtjes higjienike, ndonëse sipas aneksit përkatës ky material duhet të sigurohet nga vetë kompania dhe duhet të jetë i cilësisë së lartë dhe klasit të parë.

Autoriteti Kontraktues ka specifikuar qartë në aneks se:

“Kostoja e këtyre furnizimeve dhe shërbimeve duhet të përfshihet në çmimin total mujor të ofertës dhe nuk do të trajtohet si pozicion i veçantë për pagesë.”

Prandaj, oferta e GOE-së së propozuar për shpërblim duhet të cilësohet si ofertë jo-normalisht e ulët, pasi nuk përfshin as kostot bazike për realizimin e shërbimeve dhe furnizimeve të kërkuara për projektin.

Autoriteti Kontraktues ka vepruar gjithashtu në kundërshtim me nenin 59 të LPP-së duke e eliminuar ofertën tonë me arsyetimin se nuk e arrijmë kriterin minimal për kontrata të ngjashme në vlerë prej 1,000,000.00 EUR.

Ky konstatim është i pabazuar dhe kontradiktor, pasi nga lista e kontratave të realizuara të dorëzuara nga OE Capital X FET rezulton qartë se jo vetëm që arrihet vlera minimale e kërkuar, por ajo edhe tejkalohet.

OE Capital X FET ka ofruar listë të kontratave të realizuara në vlerë totale prej 1,663,784.55 EUR, ndërsa vetëm kontratat e realizuara gjatë tri viteve të fundit arrijnë vlerën prej 1,317,504.39 EUR, duke tejkaluar kështu kriterin minimal të kërkuar.

Në kundërshtim me nenin 72 të LPP-së “Dokumentacioni dhe Informacioni Shtesë”, Autoriteti Kontraktues nuk ka kërkuar sqarime shtesë lidhur me ofertën tonë, me qëllim të verifikimit të përmbushjes së kriterit minimal. Përkundrazi, Autoriteti Kontraktues ka vendosur në mënyrë të njëanshme ta eliminojë ofertën tonë pa kërkuar asnjë sqarim

shtesë, gjë që dëshmon qasje diskriminuose dhe të njëanshme, e cila reflektohet edhe në mosofrimin e qasjes së plotë në dokumentacion.

Oferta jonë është ofertë e përgjegjshme dhe plotësisht në përputhje me kërkesat e FTD-së dhe DT-së.

Sa i përket operatorëve të tjerë ekonomikë pjesëmarrës në këtë aktivitet prokurimi, edhe pse qasja në dokumentacion nuk është ofruar e plotë, vërehen mangësi të shumta që i bëjnë ofertat e tyre të papërgjegjshme.

Lidhur me OE Guard de Capital SH.P.K., Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 59 dhe nenin 61 të LPP-së, duke mos e cilësuar ofertën si jo-normalisht të ulët. Edhe ky operator ekonomik, njëjtë si GOE-ja e propozuar për shpërblim, me çmimin e ofertuar nuk mund të mbulojë kostot reale të projektit.

Nga kalkulimi rezulton se vetëm pagat për 36 muaj arrijnë vlerën prej 669,060.00 EUR me TVSH, ndërsa çmimi total i ofertës është 669,132.00 EUR. Kjo nënkupton se i gjithë furnizimi me material higjienik do të realizohej me vetëm 72 EUR për 36 muaj, respektivisht rreth 2 EUR në muaj, gjë që është praktikisht e pamundur dhe dëshmon qartë se oferta është jo-normalisht e ulët.

Po ashtu, edhe për këtë operator ekonomik Autoriteti Kontraktues ka klasifikuar padrejtësisht dokumente si sekrete afariste, përfshirë deklaratat nga ATK, ndonëse këto dokumente janë të qasshme publikisht përmes raportimeve në KKRF.

Oferta e këtij operatori ekonomik është e papërgjegjshme dhe me çmimin e ofruar është e pamundur të realizohet kontrata.

Sa i përket OE Efa Dienstleistung GmbH – Dega në Kosovë, Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 59 të LPP-së, pasi operatori ekonomik nuk ka dorëzuar specifikimet e vulosura dhe të nënshkruara sipas kërkesave të DT-së.

Po ashtu, edhe pse Autoriteti Kontraktues nuk ka ofruar qasje në dokumentacionin lidhur me pajisjet, ekziston dyshimi i bazuar se ky operator ekonomik nuk posedon kamionin me korpë me gjatësi minimale 25m, siç është kërkuar në FTD dhe DT, rrjedhimisht nuk i plotëson kriteret e përcaktuara.

Sa i përket GOE Internacional Group Base SH.P.K. & Skyfterat-Live SH.P.K., Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 59 të LPP-së, pasi GOE-ja nuk ka ofruar dëshmi valide (atest) që vërteton se automjeti në pronësi të Dardaniaa SH.P.K. posedon gjatësinë e kërkuar prej 26m.

Po ashtu, deklaratat për specifikimet dhe specifikimet teknike nuk janë vulosur dhe nënshkruar nga të gjithë anëtarët e GOE-së, ndërsa faqja e fundit e specifikimeve nuk është vulosur apo nënshkruar nga asnjëri prej anëtarëve të konsorciumit.

Sa i përket GOE Selmans Network SH.P.K. & N-Large SH.P.K., vetë Autoriteti Kontraktues e ka eliminuar këtë GOE për mosplotësim të kërkesave lidhur me certifikimet ISO dhe mungesën e dëshmisë së qarkullimit për kamionin me korpë. Autoriteti Kontraktues ka kërkuar sqarime shtesë nga ky GOE, mirëpo i njëjti nuk është përgjigjur, duke u konsideruar kështu palë pa interes dhe i eliminuar nga aktiviteti i prokurimit.

Sa i përket GOE KRASNIQI SH.P.K. & NTP BENI, OE KRASNIQI SH.P.K. nuk ka plotësuar Aneksin 2 – Deklarata nën Betim në formën e përcaktuar me DT dhe LPP, pasi nuk është plotësuar rubrika “operatori ekonomik që paraqitet”, gjë që e bën deklaratën të pavlefshme.

Po ashtu, në këtë dokument janë përfshirë pjesë të Aneksit 1 – Specifikimet Teknike, në kundërshtim me formën standarde të deklaratës nën betim. Mosplotësimi korrekt i deklaratës nën betim përbën bazë për eliminim automatik nga aktiviteti i prokurimit.

Ndërsa OE NTP BENI ka shënuar në mënyrë të pasaktë emrin e pronarit në deklaratën nën betim, gjë që po ashtu e bën dokumentin të pavlefshëm.

Nga qasja e pjesshme e ofruar rezulton se anëtari i konsorciumit KRASNIQI SH.P.K. nuk

ka plotësuar Aneksin 3 për sekret afarist, megjithatë Autoriteti Kontraktues ka klasifikuar dokumentet e këtij operatori ekonomik si sekrete afariste pa ekzistuar kërkesë përkatëse nga vetë operatori ekonomik.

Po ashtu, deklarata për specifikime nuk është vulosur dhe nënshkruar nga anëtari KRASNIQI SH.P.K., ndërsa specifikimet teknike nuk janë vulosur dhe nënshkruar nga të gjithë anëtarët e GOE-së.

Autoriteti Kontraktues ka përdorur standarde të dyfishta gjatë vlerësimit të ofertave, pasi për operatorët ekonomikë të propozuar për shpërblim nuk ka ofruar qasje në dokumentet bazike si certifikatat ISO, marrëveshjet dhe dëshmitë për kamionin me korpë, deklaratat nën betim, deklaratat mbi specifikimet dhe specifikimet teknike të vulosura dhe të nënshkruara, ndërsa për operatorë të tjerë ekonomikë, pavarësisht pretendimeve për sekret afarist, dokumente të tilla janë ofruar.

Prandaj, konstatohet se Autoriteti Kontraktues, duke fshehur dokumentet e lartcekura, ka bërë shkelje të dispozitave të LPP-së dhe potencialisht ka konsumuar elemente të përgjegjësisë penale, pasi dokumentet në fjalë nuk mund të konsiderohen sekrete afariste, duke qenë se janë dokumente të lëshuara dhe të përdorura për nevoja të projektit publik.

Pas analizimit të dokumenteve të ofruara në mënyrë të pjesshme, konstatohet se Autoriteti Kontraktues, me rastin e shpalljes fitues të GOE AROMA PLUS SH.P.K. & ALLTON SH.P.K., ka bërë shkelje të dispozitave të LPP-së.

Po ashtu, Autoriteti Kontraktues nuk ka bërë ekzaminim, vlerësim dhe krahasim të drejtë të ofertave të OE Guard de Capital SH.P.K., Internacional Group Base SH.P.K. & Skyferat-Live SH.P.K., Efa Dienstleistung GmbH – Dega në Kosovë, si dhe GOE KRASNIQI SH.P.K. & NTP BENI, ndonëse këto oferta rezultojnë të papërgjegjshme si në aspektin administrativ ashtu edhe financiar.

Në anën tjetër, oferta jonë, e cila është oferta e vetme e përgjegjshme dhe me çmimin më të ulët, është eliminuar në mënyrë të njëanshme dhe të pabazuar, duke dëmtuar rëndë operatorin ekonomik pjesëmarrës dhe vetë aktivitetin e prokurimit.

Për këto arsye kërkohet:

- Të anulohet Vendimi B58 për shpërblim me kontratë;
- Lënda të kthehet në rivlerësim;
- Të propozohet OE Capital X FET për shpërblim me kontratë si operatori i vetëm ekonomik i përgjegjshëm me çmimin më të ulët të ofruar.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Pergatitja e ofertes

Shpenzimet e stafit ne qasje

Pergatitja e kerkeses

Pergatitja e ankeses

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës së tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

***Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.